



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2025

VENDIM

Nr. 573, datë 31.07.2025

**PËR
PËRFUNDIMIN E KOHËZGJATJES SË KOMANDIMIT TË GJYQTARIT
Z. {...} NË POZICIONIN “KËSHILLTAR JURIDIK”, NË GJYKATËN
EVROPIANE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimet e tij nr. 731, datë 07.12.2023 Për komandimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin “këshilltar juridik”, në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut”, dhe nr. 750, datë 18.12.2024 “Për përsëritjen e komandimit të gjyqtarit z. {...} në pozicionin “këshilltar juridik”, në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut,” me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtarit z. {...} në pozicionin “këshilltar juridik”, në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut, në fund të afatit të komandimit, më datë 31.08.2025.
2. Kthimin e gjyqtarit z. {...} në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtarit të komanduar z. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si edhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR